



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

17 Nr. -062/01-32582 dt. 16/07/ 2021

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 18.06.2021, ora 10:00.

Mbledhjen ë kryesoi: Labinot Halilaj- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Gani Podrimqaku, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, Burim Bujupi si dhe prezent gjatë këtij takimi ishin: Nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rënd dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 24. 05.2021.
2. Propozim Vendim i pikës 17,të nenit 1, të Vendimit nr. 12-360-68569, të dt. 29.11.2019,të Kuvendit Komunal të Drenasit.
3. Draft -Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2022-2024.
4. Të ndryshme

Kryesuesi e Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës.

Nënkryetari i Komunës Arben Shala, propozoi edhe tri pika shtesë për rendin e ditës:

- 1. Propozim vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zvdrejtor në Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit, i plotësuar.**
- 2. Propozim vendim për shfuqizimin e pikës 2.4 të nenit 2, të Vendimit nr. 12-360/02-9351, të dt. 26.02.2021 të Kuvendit Komunal të Drenasit, i plotësuar.**
- 3. Shkresë lidhur me koston e kontratave kolektive.**

Kryesuesi e Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hodhi në votim rendin e ditës me këto tri pika shtesë të cekura më lartë që i propozoi nënkryetari Arben Shala. Prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar, dhe votuan në mënyrë anonime për këtë rend dite.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 24. 05.2021.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, ku të pranishëm ishin 6 anëtar, dhe votuan në mënyrë anonime me: 6 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim Vendim i pikës 17, të nenit 1, të Vendimit nr. 12-360-68569, të dt. 29.11.2019, të Kuvendit Komunal të Drenasit.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, ku të pranishëm ishin 6 anëtar, dhe votuan në mënyrë anonime me: 6 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Draft -Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2022-2024.**

Drejtori i Financave Shyqeri Bublaku, sa i përket kornizës afatmesme buxhetore për vitin 2022-2024, kriteret e hartimit të buxhetit komunale është 10 % i buxhetit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës ndahet për komunat, kriteret bazike të cilat ndikojnë në grandin e përgjithshëm për komuna janë numri i popullsisë llogaritet me 89 %, përmasat gjeografike të komunës me 6 % numri i popullsisë pakice me 3 % dhe komunat ku shumica e popullsisë të cilës janë pakice ndërkombëtare janë me 2 %. Ndërsa sa i përket grandit për arsim kriteret për ndarjen e buxhetit janë numri i nxënësve të regjistruar për vitin shkollor përkatës, dhe raporti nxënës mësimdhënës në arsim fillor dhe të mesëm, për shëndetësi kriteret kryesore për ndarjen e buxhetit janë vizita për kokë banori, shërbimet për kokë banori dhe kosto mesatare për vizitë, këto janë kriteret që e përcaktojnë kufijtë buxhetor për komunë. Për vitin 2022 është paraparë që buxheti për komuna të jetë 190.530.000 euro dhe me këtë shumë komunës së Drenasit ju kanë ndarë prej 15.399.334€ për vitin 2022, ndërsa për vitin 2023 është 16.620.657 € ndërsa për vitin 2024 është 17.434.862 € siç po shihet nga viti 2022 fillon rritja e buxhetit. Për paga dhe mëditje nuk është lejuar rritja nga viti 2021 por vetëm 0.5 % për përvojën e punës është 8.743.500 €, ndërsa për mallra dhe shërbime shuma prej 1.988.380 është rrit për 20 mijë euro nga viti i kaluar, shpenzimet komunale janë rrit në vlerë prej

323.508 €, subvencione dhe transfere janë parapare shumë prej 370.000€, dhe shpenzime kapitale janë 4,420,702 € shuma totale gjithsej 15.846.091 €. Ndërsa kërkesa fillestare për vitin 2023 për paga parashihet 8.787.2018, për mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale, dhe subvencione dhe transfere mbetet e njëjte sikur vitin 2022 ndërsa shpenzime kapitale parashihet të rritet në shumë prej 5.121.552 € apo shuma totale buxhetit për vitin 2022-2023 parashihet të jete 16.620.657 €. Ndërsa sa i përket vitit 2024 edhe këtu e kemi trendin e njëjte paga dhe mëditje rritet vetëm me 0.5% mallra dhe shërbimet mbetet e njëjte, shërbime komunale dhe subvencione dhe transfere mbetet e njëjte ndërsa rriten investimet kapitale në vlerë prej 5.921.820 € gjithsej shuma totale për vitin 2024 është 17.434.852 €, këtu janë parashiku të gjitha edhe grandit qeveritar edhe të hyrat vetanake në këtë projektion.

Pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, ku të pranishëm ishin 6 anëtar, dhe votuan në mënyre anonime me: 6 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: 4. Propozim vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zvdrejtor në Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit, i plotësuar.

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, ju njoftoj se ky propozim vendim ka kaluar në seancën e kaluar mirëpo pas dërgimit për ligjshmëri është kërkuar që tek pika tre të shtohet një vit shkollor të ceket fjala shkollor për këtë arsyeje jemi obliguar që prapë ta hedhim në kuvend.

Pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, ku të pranishëm ishin 6 anëtar, dhe votuan në mënyre anonime me: 6 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: 5. Propozim vendim për shfuqizimin e pikës 2.4 të nenit 2, të Vendimit nr. 12-360/02-9351, të dt. 26.02.2021 të Kuvendit Komunal të Drenasit, i plotësuar.

Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu, këtë propozim vendim e kemi sjellë prapë sepse është kthyer nga MAPL-ja sepse nuk ia kanë dërguar arsyetimin bashkë me vendim gjë që është dashtë që t'ju dërgohet edhe arsyetimi dhe për këtë arsyeje duhet edhe një herë ta dëgjomë për MAPL.

Pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, ku të pranishëm ishin 6 anëtar, dhe votuan në mënyre anonime me: 6 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: 6. Shkresë lidhur me koston e kontatave kolektive

Drejtori i Financave Shyqeri Bublaku, drejtorja e financave duke e shikuar trendin e kërkesave të cilat po vijnë nga punëtorët e sektorit të arsimit dhe shëndetësisë dhe duke e shikuar koston e tyre kemi përgatitur e kemi përgatitur një shkresë për ministrinë e financave, ministrinë e arsimit shkencës dhe teknologjisë, dhe ministrinë e shëndetësisë, kontratatave kolektive dihet që janë nga niveli qendror ndërsa kosto në barrën e komunës, kufijtë

buxhetor të cilët na dërgohen në qarkoren buxhetore nuk na lejon neve që t'i parashohim në buxhet kështu që po i mbetet komunës që të ngarkohet ose mallra dhe shërbime ose investime kapitale ose subvencionet, kosto e këtyre kontratave është afër 5.822.476.34 €, tani e kemi te njëjtën që kemi me e dergu me kornizën afatmesme buxhetore si kërkesë të komunës së Drenasit.

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, ju njoftoj rreth shujtave është për kalkulimi dhe është kjo kosto rreth 5 milion e 100 mijë janë gjitha shpenzimet që dalin nga kontrata kolektive prej 10 prillit 2017 deri në përfundim të vitit 2022, ju njoftoj se ne si ekzekutiv e kemi diskutuar disa herë me e gjet një zgjidhje që me fillu me i pagu këto obligime që dalin prej kontratës kolektive, kemi menduar me bartje të vitit të kaluar mirëpo ligji për financa nuk na ka lejuar sepse ato janë taksa të qytetareve dhe nuk guxojmë me i dërgu në mëditje.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Të ndryshme**

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoj rreth ores 10:50 min

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Labinot Halilaj